

VENDIM
Nr. 387, datë 2.5.2013

PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT,
PËR VITIN 2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 54 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2013, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë t’i përcjellë menjëherë Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet e miratuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha